

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 nga Udhëzimi për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-335/1 datë 23.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-365/5 datë 30.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 3-të mbajtur më 29.01.2025, miratoi si vijon:

**Aktvendim
për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen me ritransmetim
të shërbimit programor**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-335/1 datë 23.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET që operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, përkatësisht të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, vepron sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe për përjashtim të ritransmetimit të shërbimeve programore.

4. Derisa subjekti i mbikëqyrjes i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit përkatësisht vazhdon me kryerjen e shkeljes për të cilën është paralajmëruar, Agjencia, në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LSHMAAV ose të dispozitave miratuar në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë,, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore, në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 21.01.2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të pakos programor të ritransmetuar nga operatori Shoqërisë për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, ku është konstatuar se operatori në fjalë që sipas njoftimit nga

Agjencia për Komunikime Elektronike mund të ushtroj veprimtari të territorin e komunës së Gostivarit, Vrapçishtë, Bogovinë dhe Kërçovë, me datë 21.01.2025, për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor, që nuk përfshihet në çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-335/1 datë 23.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-335/1 datë 23.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-365/5 datë 30.01.202, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV paraqitur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim, me të cilin ndaj subjektit të paraqitur të ndërmerret masë paralajmërim publik dhe detyrohet që menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që të ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Agjencia do të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë vepron sipas urdhërësës, përkatësisht sipas vërejtjes publike dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-335/1 datë 23.01.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.